



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I MBIKËQYRJES FINANCIARE
BORDI**

VENDIM

Nr. 176, datë 31.10.2025

**PËR
MIRATIMIN E AGJENTËVE NË SIGURIME NË EMËR DHE PËR LLOGARI TË
SHOQËRISË “UNION DISTRIBUCION SERVIS ALBANIA” SH.P.K.**

Në bazë dhe për zbatim të nenit 14, pika 4, të Ligjit nr. 9572, datë 03.07.2006 “Për Autoritetin e Mbikëqyrjes Financiare”, i ndryshuar, Ligjit nr. 52, datë 22.05.2014 “Për veprimtarinë e sigurimit dhe risigurimit”, si dhe të Rregullores nr. 79, datë 31.08.2015 “Për miratimin/licencimin e personave për të ushtruar veprimtarinë e agjentit në sigurime si dhe rastet e mospranimit të regjistrimit të tij dhe refuzimit të licencës”, e ndryshuar, Bordi i Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare,

V E N D O S I:

- 1. Miratimin e z. Ermir Rysta, z. Ilir Hajdarasi, z. Elidon Nivica, z. Armand Lusha, zj. Elda Doçi, z. Ndrëçim Dushku, z. Olger Muja, zj. Mirea Gjuzi dhe zj. Ina Grori, për të ushtruar veprimtarinë e agjentit në sigurime, në klasat e jojetës, në emër dhe për llogari të shoqërisë “Union Distribucion Servis Albania” sh.p.k.**
- 2. Ngarkohet Drejtoria e Licencimit, për njoftimin dhe ndjekjen e zbatimit të këtij vendimi.**

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**KRYETAR
Saimir TOLA**

**DREJTOR I PËRGJITHSHËM EKZEKUTIV
Mimoza KAÇI**